

	Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrenë "UKSHIN HOTI"
Pranuar me dt.	11.10.2021
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
303	01-28217



**UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN**

**RREGULLORE
PËR PUNËN E KËSHILLIT TË FAKULTETIT**

Prizren, 2021



Në mbështetje të nenit 23 paragrafi 1.2 dhe 1.3 të Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren dhe në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, Këshilli Drejtues i Universitetit në mbledhjen e mbajtur me datën 07.10.2021 miraton:

RREGULLORE për punën e Këshillit të Fakultetit

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1) Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë mënyrën e punës së Këshillit të Fakulteteve (njësive akademike) në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren.
- 2) Kjo rregullore zbatohet për Këshillat e Fakulteteve (njësive akademike) në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren.
- 3) Shkurtesat e përdoruara në këtë rregullore kanë kuptimet e mëposhtme:
 - 3.1 Universiteti – Universiteti “Ukshin Hoti”;
 - 3.2 KF – Këshilli i Fakultetit;
 - 3.3 Kryesuesi – Dekani i Fakultetit.

Neni 2 Mbledhjet

- (1) Dekani i Fakultetit (në vijim “Kryesuesi”) thërrret dhe kryeson mbledhjen.
- (2) Në rast se Dekani mungon, mbledhjen e përgatit dhe e kryeson njëri prej prodekanëve sipas radhës së parë të përcaktuar nga dekani. Nëse edhe prodekanët nuk kanë mundësi të marrin pjesë ne mbledhje, mbledhjen e Këshillit të Fakultetit e kryeson anëtarë më i vjetër.
- (3) Kryesuesi i thërrret mbledhjet e Fakultetit sipas nevojës. Gjatë periudhës së rregullit të studimeve, mbledhjet e Këshillit të Fakultetit mbahen së paku njëherë në muaj.
- (4) Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të mbahen në çfarëdo kohe sipas procedurave të parapara. Rendi i ditës për këtë mbledhje duhet të jetë i kufizuar në një pikë kryesore. Në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit mund të vendoset për thirrjen e ndonjë mbledhje të ardhme të Këshillit të Fakultetit, në këtë rast anëtarët e Këshillit të Fakultetit që nuk janë të pranishëm duhet të ftohen posaçërisht.
- (5) Si rregull, mbledhja e organit kolegjial mbahet me prezencën fizike të anëtarëve. Me pëlqimin e shumicës së të gjithë anëtarëve apo pëlqimin e kryesuesit të Këshillit të Fakultetit, mbledhja mund të mbahet edhe me pjesëmarrjen e anëtarëve nëpërmjet videokonferencës, deklarimit përmes postës elektronike zyrtare apo me mjete të tjera të përshtatshme të komunikimit simulues në distancë.
- (6) Mbledhjet e jashtëzakonshme të Këshillit të Fakultetit i thërrret kryesuesi ose 1/3 e anëtarëve të përgjithshëm të Këshillit të Fakultetit.
- (7) Mbledhjet e jashtëzakonshme duhet të ftohen jo më larg se 24 orë nga paraqitja e kërkesës për mbledhje.



-
- (8) Në rast të shkarkimit të dekanit, procedurën e zgjedhjes së dekanit të ri e organizon anëtarë më i vjetër me thirrje më të lartë akademike i Këshillit brenda 15 ditëve.
 - (9) Mbledhjet e Këshillit të Fakultetit janë të hapura për publikun, pos në rastet kur Këshilli i Fakultetit vendos ndryshe.
 - (10) Anëtarët e Këshillit të Fakultetit ftohen së paku 48 orë para mbledhjes. Ftesat mund të bëhen me shkrim, me fax, e-mail ose në çfarëdo forme tjeter teknike, me të cilën dërgesa dhe informimi janë të sigurta.
 - (11) Kryesuesi ka të drejtë në çfarëdo kohe të ftojë ekspertë, ose të ftojë persona të tjerë në mbledhje.
 - (12) Kryesuesi është i obliguar të thirrë mbledhjen e Këshillit të Fakultetit nëse këtë e kërkojnë së paku 1/3 e anëtarëve të Këshillit të Fakultetit dhe nëse qëllimi është i arsyetur me shkrim.

Neni 3 Pjesëmarrja në mbledhje dhe përfaqësimi

- (1) Të gjithë anëtarët e Këshillit të Fakultetit kanë të drejtë dhe janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të Fakultetit.
- (2) Gjatë mbledhjeve të Këshillit të Fakultetit, anëtarët duhet të votojnë personalisht dhe nuk lejohet delegimi i votës.
- (3) Para se të fillojë mbledhja e Këshillit të Fakultetit anëtarët do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtarë i Këshillit të Fakultetit mund të mungojë nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje anëtarë i Këshillit të Fakultetit duhet të njoftojë me kohë kryesuesin.
- (4) Mospjesëmarrja pa arsyе në tri mbledhje radhazi, automatikisht nënkuption heqje dorë nga mandati i anëtarit të Këshillit të Fakultetit. Në këtë rast, në mbledhjen e radhës ftohen anëtarë i personelit të Fakultetit i cili ka marrë më së shumti vota për anëtar të Këshillit të Fakultetit, pas kandidatit i cili tërhoqet. Zëvendësimi i anëtarit të Këshillit duhet të jetë në përputhje me dispozitat ligjore të rregullores për zgjedhjet e përgjithshme në Universitetin "Ukshin Hoti".

Neni 4 Konflikt i interesit

- (1) Anëtarë i KF ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit ndërmjet interesave të tij publike dhe private duke plotësuar formularin zyrtar të agjencionit KI-01.
- (2) Në rast se anëtarë i KF ka dyshime apo konstaton se konflikti i interesit ka lindur ose mund të lindë, ai duhet të këshillohet dhe të informojë sa më parë kryesuesin e KF. Gjatë kësaj kohe, zyrtari duhet të pezullojë të gjitha veprimet që ndërlidhen me këtë çështje, deri në vendimin përkatës në lidhje me rastin.
- (3) Dekani duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit. Kur konstaton se ekziston konflikt interesit atëherë e plotëson



formularin KI-02 dhe të njëtin ia drejton Komisionit për vlerësimin e konfliktit të interesit brenda institucionit, për evidentim dhe raport vjetor për agjencionin.

(4) Në rast se Dekani nuk është i bindur për ekzistimin e konfliktit të interesit apo dyshon se edhe vetë ka ose mund të ketë konflikt të interesit, atëherë i drejtohet komisionit të brendshëm për parandalimin e konfliktit të interesit për vlerësim. Komisioni brenda 30 ditësh në bashkëpunim me AKK nxjerr opinion lidhur me rastin duke plotësuar formularin KI-02.

(5) Për çështjet tjera lidhur me konfliktin e interesit vlejnë dispozitat e ligjit nr. 06/L-011. Agjencia është autoriteti qendror përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji.

Neni 5

Fillimi i mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës

- (1) Kryesuesi e hap, e kryeson, e ndërpert dhe e përfundon mbledhjen.
- (2) Për përgatitjen e materialeve për mbledhjen e Këshillit të Fakultetit kujdeset kryesuesi në koordinim me prodekanët dhe sekretarin e fakultetit dhe me shërbimet administrative përkatëse.
- (3) Në fillim të mbledhjes, kryesuesi konstaton prezencën e kuorumit, propozon rendin e ditës, hap diskutimin rreth rendit të ditës, konstaton miratimin apo jo të rendit të ditës.
- (4) Kuorumi i Këshillit të Fakultetit konsiderohet nëse janë prezentë shumica (50+1%) e anëtarëve të Këshillit të Fakultetit.
- (5) Në rastet kur në mbledhjen e Këshillit konstatohet mungesa e kuorumit, kryesuesi e thërrët një mbledhje të dytë në një ditë tjeter, me të njëtin rend dite, sipas pikës 10 të nenit 2 të kësaj rregulloreje. Në këtë rast, mbledhja e dytë është e vlefshme nëse në mbledhjen e Këshillit janë të pranishëm më shumë se një e treta (1/3) e anëtarëve të tij, me kushtin që njoftimet të janë bërë sipas kësaj rregulloreje dhe në njoftim të jetë përfshirë njoftimi që mbledhja e dytë do të jetë e vlefshme me këtë kuorum.
- (6) Kryesuesi është i obliguar që në rend të ditës të përfshijë propozimet e arsyetuara me shkrim 48 orë para mbajtjes së mbledhjes. Propozimet me shkrim mund të dërgohen personalisht, me fax, me e-mail dhe të nënshkruara nga parashtruesi.
- (7) Përashtimi i paragrafi 5 i këtij neni, anëtarët e Këshillit të Fakultetit kanë të drejtë që në mbledhjen e filluar të propozojnë ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës. Materialet ose kërkesat të cilat bashkëngjiten gjatë mbledhjes, për t'u bërë pjesë e rendit të ditës duhet të miratohen me shumicën e votave.
- (8) Kryesuesi ia jep fjalën secilit anëtar i cili dëshiron të diskutojë lidhur me çështjen e cila është në rendin e ditës, pas përfundimit të diskutimeve, kryesuesi konstaton mbylljen e shqyrtimit të temës së caktuar dhe çështjen e vë në votim, ku edhe konstaton miratimin ose refuzimin e propozimit. Dispozitivi i vendimit duhet të shqiptohet në të gjitha rastet pa përashtim, menjëherë pas votimit.
- (9) Kryesuesi ndërmerr masat për sigurimin e mbarëvajtjes së punës në mbledhje, konstaton përfundimin e mbledhjes dhe ndërmerr veprime të tjera të nevojshme për udhëheqjen dhe drejtimin e mbledhjes konform kësaj rregulloreje.



Ecuria e mbledhjes

Neni 6

- (1) Pas miratimit të rendit të ditës, kalohet në shqyrtim dhe vendosje për çështjet që janë në kuadër të pikave të miratuarat të rendit të ditës.
- (2) Raportin dhe arsyetimin për secilën pikë të rendit të ditës e paraqet kryesuesi ose personi i caktuar nga kryesuesi, pas të cilit kryesuesi e hap diskutimin.
- (3) Të gjithë anëtarët e pranishëm të Këshillit të Fakultetit mund të marrin pjesë në diskutim dhe t'i paraqesin mendimet dhe propozimet lidhur me çështjet që do të vendosen në mbledhje.
- (4) Kryesuesi i jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim. Në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit askush nuk mund të diskutojë pa e marrë fjalën nga kryesuesi i mbledhjes.
- (5) Kryesuesi është përgjegjës për respektimin e këtyre procedurave të punës.
- (6) Për çdo pikë të rendit të ditës pjesëmarrësit mund të diskutojnë më së shumti dy herë, herën e parë deri në pesë minuta, herën e dytë deri në dy minuta.
- (7) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë nga folësit që t'i përbahen temës.
- (8) Pjesëmarrësi i cili e merr fjalën është obliguar t'i përbahet çështjes që është në shqyrtim. Çdo pjesëmarrës që konsideron se lidhur me fjalën e tij është shtrembëruar ndonjë fakt, me lejen e kryesuesit ka të drejtë të paraqitet për replikë menjëherë pasi të përfundojë diskutimin pjesëmarrësi ndaj të cilit është paraqitur replika. Replika për të njëjtën çështje i lejohet pjesëmarrësit në diskutim vetëm dy herë dhe sipas rregullit mund të zgjatë më së shumti dy minuta.
- (9) Kryesuesi ka të drejtë të ndërpresë mbledhjen më së shumti 30 minuta. Me pajtimin e Këshillit të Fakultetit kjo mund të zgjatet.
- (10) Përashtimi nga paragrafi 9 i këtij nenit, Kryesuesi mund të ndërpresë mbledhjen në rastet si në vijim:
 - 10.1 Nëse mbledhja e Këshillit nuk mund të përfundojë në të njëjtën ditë;
 - 10.2 Nëse prishet rendi dhe qetësia në mbledhje dhe kryesuesi nuk mund të vendosë rendin dhe qetësinë për mbajtjen e mbledhjes.
 - 10.3 Vazhdimi i mbledhjes së ndërpërre duhet të bëhet brenda afatit prej 48 orësh nga ndërpërja e saj.

Neni 7

Shtyrja e çështjeve për mbledhjet e radhës

Këshilli i Fakultetit në bazë të propozimit të kryesuesit ose të ndonjë anëtarit të Këshillit të Fakultetit mund të vendosë që shqyrtimi për disa çështje specifike të ndërpitet dhe të përgatitet më hollësisht për mbledhjen e ardhme.

Neni 8

Kërkesat dhe ankesat

- (1) Çdo anëtar i Këshillit të Fakultetit ka të drejtë të parashtrojë kërkesë – ankesë për temën e caktuar apo vendimin e caktuar të Këshillit.



-
- (2) Këshilli i Fakultetit duhet të marrë parasysh kërkesat dhe ankesat e përcaktuara me paragrafin 1 të këtij neni.
 - (3) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë që kërkesa – anesa të parashtronet me shkrim.
 - (4) Këshilli i Fakultetit obligohet që të shqyrtojë dhe të vendosë për secilën kërkesë dhe ankesë të anëtar/ës të Këshillit, apo mësimdhënësit të njësisë akademike përkatëse.

Neni 15 Vendimmarrja – votimi dhe zgjedhja

- (1) Vendimet e Këshillit të Fakultetit merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në pajtim me dispozitat e kësaj irregulloreje.
- (2) Para votimit kryesuesi formulon propozimin e vendimit ose të kërkësës lidhur me atë pikë të rendit të ditës.
- (3) Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, sipas pikës së rendit të ditës Këshilli i Fakultetit merr vendim ose konkluzion. Pas votimit, pika e paraparë në rend të ditës për të cilën vendoset, Kryesuesi është i detyruar të konstatojë aprovimin apo refuzimin, si dhe të diktojë dispozitivin e vendimit në procesverbal dhe duhet të incizohet në pajtim me dispozitat e kësaj irregulloreje.
- (4) Me shumicën e kualifikuar prej 2/3 të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit merren vendimet si në vijim:
 - 4.1 Votimi për iniciimin e shkarkimit të dekanit;
 - 4.2 Votimi përkitazi me ankesën lidhur me revokimin e titullit doktor shkencë, kur plotësohen kushtet e parapara në nenin 126 paragrafi 1 alineja 6 e Statutit të Universitetit.
- (5) Nëse ka më shumë propozime të vendimeve ose të konkluzioneve, së pari votohet për ato në material ose propozimet nga autoritetet e fakultetit, pastaj për propozime të tjera.
- (6) Votimi bëhet me vota të hapura ose me votim të fshehtë. Mënyra e votimit vendoset në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit me shumicë votash.
- (7) Votimi bëhet “për”, “kundër” dhe “abstinen”.
- (8) Në rast të numrit të votave të barabarta, atëherë vota e kryesuesit të Këshillit të Fakultetit është përcaktuese.
- (9) Mbledhjet e Këshillit duhet të incizohen me diktafon dhe të hartohen në procesverbal nga ana e Sekretarit të njësisë akademike përkatëse.

Neni 10 Votimi i fshehtë

- (1) Procedurën e votimit të fshehtë e zbaton komisioni i emëruar nga Këshilli i Fakultetit i përbërë prej tre anëtarëve.
- (2) Pas votimit, në bazë të rezultateve të votimit, kryesuesi, përkatësisht kryetari i komisionit, konstaton se propozimi i vendimit ose konkluzioni është miratuar ose është refuzuar.
- (3) Votimi me vota të fshehta bëhet për:



-
- a. Nominimin e kandidatëve për Dekan për zgjedhje nga Senati;
 - b. Inicimin e shkarkimit të dekanit;
 - c. Zgjedhjen e kryesuesit të përkohshëm të Këshillit të Fakultetit i cili do të jetë edhe përfaqësues dekan në Senat;
 - d. Çështjet që prekin intimitetin e ndonjërit nga anëtarët e Këshillit të Fakultetit;
 - e. Çështjet kur kryesuesi kërkon votim të fshehtë.

(4) Numërimi i votave për çështjet e parapara në paragrin 3 të këtij neni bëhet nën mbikëqyrjen e Sekretarit të Fakultetit.

Neni 11 Mbajtja e rendit në mbledhje

- (1) Për mbajtjen e rendit në mbledhje kujdeset kryesuesi i mbledhjes.
- (2) Kryesuesi dhe pjesëmarrësit në mbledhje të Këshillit të Fakultetit janë të obliguar që t'i përmbahen rregullave dhe procedurave të mbledhjes.
- (3) Për shkeljen e rendit dhe qetësisë në mbledhjen e Këshillit, mund të shqiptohen këto masa:
 - 3.1 Vërejtje verbale;
 - 3.2 Marja e fjalës;
 - 3.3 Largim nga mbledhja.

Neni 12 Shqiptimi i masave

- (1) Vërejtja verbale mund t'i shqiptohet të pranishmit nëse me sjelljen dhe me diskutimin e tij e pengon punën normale të mbledhjes.
- (2) Marja e fjalës i shqiptohet anëtarit nëse me sjelljet dhe me deklaratën e tij e pengon punën normale të Këshillit të Fakultetit për të cilën më parë i është shqiptuar vërejtja.
- (3) Vërejtjen dhe martjen e fjalës e shqipton kryesuesi.
- (4) Largimi nga mbledhja i shqiptohet pjesëmarrësit nëse edhe pasi t'i merret fjalë pengon mbarëvajtjen e mbledhjes.
- (5) Largimin nga mbledhja e shqipton Këshilli i Fakultetit me shumicë votash. Pjesëmarrësit të cilët i është shqiptuar kjo masë është i detyruar që menjëherë të largohet nga mbledhja. Largimi nga mbledhja bëhet vetëm për atë mbledhje.

Neni 13 Procesverbali nga mbledhja

- (1) Në çdo mbledhje të Këshillit të Fakultetit mbahet procesverbali. Prosesverbalin e nënshkruajnë kryesuesi dhe procesmbajtësi.
- (2) Prosesverbali duhet të përbajë këto elemente.
 - a. Vendin, datën, kohën e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes.
 - b. Rendin e ditës.
 - c. Listën e pjesëmarrësve dhe atyre që mungojnë.
 - d. Propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse.



e. Shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes.

- (3) Dokumentet shtesë duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit.
- (4) Prosesverbalit duhet të përgatitet brenda një javë pas mbledhjes së Këshillit të Fakultetit dhe si ekstrakt duhet të i dërgohet anëtarëve të Këshillit të Fakultetit me rastin e dërgimit të materialit për mbledhjen e ardhshme.
- (5) Prosesverbalit miratohet në mbledhjen e radhës së Këshillit të Fakultetit.
- (6) Prosesverbalit ruhet në arkiv të Universitetit, me materialet e shqyrtuara sipas pikave të rendit të ditës si dokumente afatgjata.

Neni 14 Aktet e Këshillit të Fakultetit

(1) Këshilli i Fakultetit nxjerr:

- Vendime
- Konkluzione
- Rekomandime

- (2) Dispozitivi i vendimeve, konkluzioneve apo rekomandimeve të cilat i nxjerr Këshilli i Fakultetit duhet të diktohen në procesverbal nga ana e kryesuesit pas votimit.
- (3) Mbledhjet e Këshillit incizohen në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, në asnje rrëthanë personi përgjegjës nuk ka drejtë të publikojë incizimet e mbledhjeve, me përashtim të rasteve kur një të tillë e kërkojnë organet e hetuesisë dhe gjykata.
- (4) Mbledhjet elektronike duhet të incizohen dhe ruhen në arkivën e Fakultetit përkatës.
- (5) Këshilli i Fakultetit i jep interpretim autentik dokumenteve që i lëshon.
- (6) Prosesmbajtësi është i obliguar t'i përgatit vendimet, konkluzionet dhe rekomandimet nga mbledhja e Këshillit të Fakultetit.

Neni 15 Vlefshmëria e dispozitave të kësaj rregulloreje

- (1) Dispozitat e këtyre rregullave dhe procedurave vlejnë për të gjithë anëtarët e Këshillit të Fakultetit dhe për personat e tjera të ftuar apo të angazhuar në Këshillin e Fakultetit.
- (2) Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore, zbatohen dispozitat e Statutit dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi.

Neni 16 Dispozitat përfundimtare

- (1) Për zbatimin e drejtë të këtyre procedurave kujdeset kryesuesi i Këshillit të Fakultetit.
- (2) Interpretimin autentik të kësaj procedure e jep Këshilli Drejtues.
- (3) Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje mund të bëhet sipas së njëjtës procedure të miratimit.



Neni 17
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit, shfuqizohet rregullorja nr. 01-480 e datës 28.12.2015 mbi zgjedhjet në Universitetin "Ukshin Hoti" dhe punën e Këshillit të Fakultetit.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrija

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Arif Murrija', is written over a blue horizontal line that spans the width of the text above it.